Me datë 08.08.2025 është mbajtur takim punë nga selektorët e Kosovës në gjimnastikë, Abeliana Bregu, Doruntinë Ibrahimi. Takimi kishte për qëllim analizimin e rezultateve të garave të vitit 2025, si bazë për përzgjedhjen e përfaqësueses së Kosovës për pjesëmarrje në tri gara ndërkombëtare të ardhshme:

1. **Kampionati Mesdhetar – COMEGYM Championship**
2. **Kampionati Ballkanik** dhe
3. **Gara Horizon Cup 2025**.

1. Kampionati Mesdhetar – COMEGYM Championship, Turqi (03-07 Tetor 2025)

Gjimnastet e përzgjedhura:
Juniore: **Bora Hoti, Rea Berisha, Sara Pllana**
Trajnerë: **Doruntinë Ibrahimi, Abeliana Bregu,**
Doktor: **Blerina Mema.**

2. Kampionati Ballkanik – Zadar, Kroaci (02–06 nëntor 2025)

Gjimnastet e përzgjedhura:
Juniore: **Bora Hoti, Rea Berisha, Sara Pllana**
Youth: **Fernaze Cakaj, Djellona Azemi, Jora Gërvalla**
Pre-Youth: **Hira Haziri, Borë Krasniqi, Hira Elshani**
Head of delegation: **Besnik Latifi**
Trajnerë: **Doruntinë Ibrahimi, Abeliana Bregu, Arlind Shaqiri.**
Doktor: **Blerina Mema,**

3. Horizon Cup – Selanik, Greqi (07–09 nëntor 2025)

Gjimnastet e përzgjedhura:
Juniors: **Elisa Bugaçku, Elena Sefa, Vlera Gërguri.**
Pre-Juniors: **Hira Haziri, Rene Xhambazi, Troja Haradinaj, Tiara Dragusha, Elma Gashi**
Gjyqtar: **Arlind Shaqiri (national)**
Trajnerë: **Lisa Zeqiri, Sherife Qerimi, Qendresa Ramadani,**
Doktor: **Blerina Mema.**

Arsyetimi për përzgjedhjen e bërë:

Duke analizuar pikët e garave gjatë vitit 2025, dhe duke ju dhënë prioritet garave me vlerësim me Kod të Poentimit (FIG COP), janë bërë përzgjedhjet për gara.Në Ekipin për kampionatint Ballkanik janë shtuar Jora Gërvalla, Borë Krasniqi dhe Hira Elshani, si gjimnastet me rezultatin më të mirë në gara me vlerësim me COP. Për garën Horizon Cup, në kategorinë Pre-Juniors numri maksimal i gjimnasteve që Federata e Gjimnastikës e Kosovës mund të regjistrojë është 5. Si rrjedhojë, jashtë listës kanë mbetur disa gjimnaste si Vanesa Haziri, Sumeja Hoxha, Adea Shala, Olta Breznica etj., të cilat krahasuar me emrat e përzgjedhur kanë rezultate më të ulëta në garat e vitit 2025. Vlera Gërguri dhe Elena Sefa si gjimnaste me përvojë në gara ndërkombëtare ndër vite, nuk kanë marrë pjesë në garën seleksionuese të 30 prillit dhe 1 majit, pasi në këtë rast u është dhënë hapësira gjimnasteve që nuk kanë garuar më parë për Kosovën, për t'u përfshirë në garën "Confsport Italia". Duke marrë parasysh nivelin e tyre të mirë të gjimnastikës dhe mungesën e junioreve të tjera me rezultate të krahasueshme, ato janë përfshirë në listën garuese për Horizon Cup për të përfaqësuar Kosovën. Për referencë më të lehtë të rezultateve, në tabelën e mëposhtme janë rezultatet e secilës gjimnaste gjatë vitit 2025 deri tani:

GJIMNASTJA	REZULTATI
Sara Pllana	Salamunov Memorial: 43.650 EYOF: 43.100
Bora Hoti	Salamunov Memorial: 38.350 EYOF: 40.600
Rea Berisha	Salamunov Memorial: 36.400 EYOF: 37.100
Fernaze Cakaj	Salamunov Memorial: 43.366
Hira Haziri	Salamunov Memorial: 39.999
Djellona Azemi	Salamunov Memorial: 26.916
Hira Elshani	Salamunov Memorial: 21.816
Borë Krasniqi	Salamunov Memorial: 26.333
Elma Gashi	Confsport Italia (Elite sipas COP): 26.650 Salamunov Memorial: 31.133
Jora Gërvalla	Confsport Italia (Elite sipas COP): 34.550
Tiara Dragusha	Confsport Italia (Elite sipas COP): 30.950
Elisa Bugaçku	Confsport Italia (Elite sipas COP): 28.800 Salamunov Memorial: 24.450
Troja Haradinaj	Rezultat të mirë në Confsport Italia (jo garë me COP)
Rene Xhambazi	Rezultat të mirë në Confsport Italia (jo garë me COP)